



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Ligji Nr. 03/L-085**

**DRAFT LIGJI PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES SË UNMIK-UT 2003/16 PËR  
SHPALLJEN E LIGJIT PËR TELEKOMUNIKACION TË MIRATUAR NGA  
KUVENDI I KOSOVËS**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës,**

Duke u bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut 2003/16 për Shpalljen e Ligjit për Telekomunikacion të Miratuar nga Kuvendi i Kosovës ("Ligji"),

Duke marrë parasysh nevojën për të ndryshuar Ligjin në mënyrë që arrihet pajtueshmëri me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe instrumentët tjerë relevantë,

Miraton këtë

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN E LIGJIT PER TELEKOMUNIKACION TË MIRATUAR  
NGA KUVENDI I KOSOVËS**

**Neni 1**

Teksti i tërë pjesës hyrëse të Ligjit të zëvendësohet me formulimin në vijim:

"Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Duke u bazuar në autoritetin e dhënë nga neni 65, 119.5 dhe 142 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Duke njohur nevojën për përmirësimin e sektorit të telekomunikacionit në Kosovë: me krijimin e Autoritetit të Pavarur Rregullator i cili do të jetë përgjegjës për licencimin, rregullimin dhe menaxhimin e ofruesve të shërbimeve të telekomunikacionit në Kosovë; inkurajimin e pjesëmarrjes së sektorit privat dhe konkurrencën lojale në përputhje me dispozitat në fuqi, rregullimin e standardeve unike për të gjithë ofruesit e shërbimeve në Kosovë dhe mbrojtjen e konsumatorëve të këtyre shërbimeve:

Miraton këtë

## **LIGJ PËR TELEKOMUNIKACIONIN**

### **Neni 2**

Në nenin 2 të Ligjit, paragrafi i titulluar "Kuvendi" të zëvendësohet në tërësi me formulimin në vijim:

Kuvendi - Kuvendi i Republikës së Kosovës

### **Neni 3**

Në nenin 2 të Ligjit, paragrafi i titulluar "AKM" të zëvendësohet në tërësi me formulimin në vijim:

AKM – Institucioni pasardhës i Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit në pajtim me Ligjin mbi Agjencinë e Privatizimit të Kosovës.

### **Neni 4**

Në nenin 2 të Ligjit, paragrafi i titulluar "Ministri" të zëvendësohet në tërësi me formulimin në vijim:

“Ministria” - Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit

### **Neni 5**

Në nenin 2 të Ligjit, të fshihet në tërësi paragrafi i titulluar "IPVQ."

### **Neni 6**

Neni 3.1 (a) i Ligjit të zëvendësohet në tërësi me nenin 3.1 (a) në vijim:

a) Ministria, harton politika për sektorin e telekomunikimit, duke përfshirë edhe hartimin e legjislacionit.

## **Neni 7**

Neni 3.1 (b) i Ligjit të zëvendësohet në tërësi me nenin 3.1 (b) në vijim:

b) ART, i themeluar me këtë ligj, si një trup rregullator i pavarur, mban përgjegjësinë për implementimin e politikave të Qeverisë dhe Ministrisë, të udhëhequra nga ky ligj si dhe të gjitha pjesët legjislative në pajtim me këtë ligj.

## **Neni 8**

Neni 3.1 (c) i Ligjit të fshihet në tërësi.

## **Neni 9**

Në nenin 3.2 të Ligjit, shprehja "Komisioneri i Përkohshëm i Mediave" të zëvendësohet me shprehjen "Komisioni i Pavarur për Media".

## **Neni 10**

Neni 3.3 i Ligjit të zëvendësohet në tërësi me nenin 3.3 në vijim:

(3) ART-ja u cakton ofrueseve të shërbimeve, burime spektrale në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe ligjve të tjera në fuqi.

## **Neni 11**

Neni 3.5 i Ligjit të fshihet në tërësi.

## **Neni 12**

Neni 4.1 i Ligjit të zëvendësohet në tërësi

me nenin 4.1 në vijim:

(1) Autoriteti Regullator Telekomunikacionit ("ART") themelohet si autoritet i pavarur, rregullator, dhe zbaton politikat e Qeverisë dhe Ministrisë, në pajtim me këtë ligj si dhe në pajtim me të gjitha legjislacionet të nxjerra për implementimin e këtij ligji.

### **Neni 13**

Neni 19 i Ligjit fshihet.

### **Neni 14**

Në nenin 22.2 të Ligjit, shprehja "PSSP" të zëvendësohet me fjalën "Kuvendi".

### **Neni 15**

Në nenin 26.4 të Ligjit, pika (a) fshihet.

### **Neni 16**

Në neni 26.7 të Ligjit, pika (e) fshihet.

### **Neni 17**

Neni 28. 1 dhe 28.2 të Ligjit të zëvendësohen në tërësi me nenin 28.1 në vijim:

(1) Ofruesit e shërbimeve që dëshirojnë të përdorin frekuencat do të marrin të drejtën për përdorimin e frekuencave të tilla nga ART-i para fillimit të ofrimit të shërbimeve. ART-i do të akordojë të drejtën për përdorimin e radio frekuencave sipas këtij ligji dhe legjislacioneve tjera përkatëse.

### **Neni 18**

Nenin 36 i Ligjit fshihet.

### **Neni 19**

Në nenin 37.1 të Ligjit, numri "66" të zëvendësohet me numrin "68".

## **Neni 20**

Në nenin 40.3 të Ligjit, të shtohet shprehja "ose legjislacioni pasardhës relevant" në fund të fjalisë.

## **Neni 21**

Në nenet 42 dhe 46 të Ligjit, të fshihet shprehja "rregulloret e UNMIK-ut".

## **Neni 22**

Neni 58.6 ( c) i Ligjit të zëvendësohet në tërësi me nenin 58.6 ( c) në vijim:

c) pajisjet për radio dhe terminale që janë ta mbuluara me ligjet e Kosovës;

## **Neni 23**

Neni 63.1 i Ligjit të zëvendësohet në tërësi me nenin 63.1 në vijim:

(1) Spektri i radio frekuencave është një burim i kufizuar natyror. ART-ja do t'i caktojë ofruesve të shërbimeve burime spektrale vetëm në pajtim me dispozitat e këtij ligji

## **Neni 24**

Neni 63.3 i Ligjit të zëvendësohet në tërësi me nenin 63.3 në vijim:

(3) Plani i ART-it për burimet e spektrit do të hyjë në fuqi pasi shqyrtimit dhe miratimit paraprak me shkrim nga Kuvendi.

## **Neni 25**

Në nenet 64.2, 64.3 dhe 66.1 të Ligjit, shprehja "PSSP" të zëvendësohet me fjalën "Kuvendi".

## **Neni 26**

Në nenet 64.2 dhe 75.2 të Ligjit, të fshihet shprehja "dhe rregulloret e UNMIK-ut"

## **Neni 27**

Neni 80 i Ligjit të zëvendësohet në tërësi me nenin 80 në vijim:

"Ky Ligj hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 03/L-085**  
**13 qershor 2008**

**Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,**

---

**Jakup KRASNIQI**